REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 154/17
Datë/Datum. 07-06-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Këshilli Prokurorial i Kosovës**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **154/17** e OE **"Office Printy"** - Prishtinë.		
Datë:	07.06.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 25.05.2017 me Nr. **154/17** nga OE **"Office Printy"** - Prishtinë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me fasiklla te kartonit te fort me spag (litar konop) formati B4"**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Prokurorial i Kosovës**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **OFFICE PRINTY.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		29.05.2017		**29.05.2017**		**07.06.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 25.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **154/17** e parashtruar nga OE **"Office Printy",** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me fasiklla te kartonit te fort me spag (litar konop) formati B4"**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Prokurorial i Kosovës.** Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Këshillit Prokurorial të Kosovës.**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Office Printy", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Office Printy"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

- Neni 1-Qëllimi pika 1 dhe 2
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7-Barazia ne trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 59-Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 53- Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
- Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 28-Specifikimet teknike
- Neni 38 i Rregullat dhe udhëzuesi operative i PP-se.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

I pakënaqur ne vendimin nr.665/2017 te datës 18/05/2017 ku AK merr vendim qe ta refuzoj kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se: Juve ju është dërguar Letra standarde e kërkesës për informata mbi tenderin jo-normalisht te ulte. Përgjigjen qe e kemi marr nga ana e Juaj ka qene jo bindëse për AK dhe ne baze te nenit 4 paragrafi 4.6.2 tenderi i juaj është refuzuar ne përputhje me nenin 61 te LPP." prandaj ne afatin e lejuar ushtroje këtë:

ANKESE: te vendimin per shkak:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike
- Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale.

A r s y e t i m.

-Me daten 16/05/2017 ne ora 9.13h kemi pranuar nga ana e AK B41 Letren standarde e kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulte ku AK ka kerkuar: " A qendroni mbrapa çmimit te ofruar dhe a mund te sillni kartonat ashtu siq ju kemi treguar mostrat?. Te njejten dite me 16.05.2017 ne ora

10.12 h ne kemi konfirmuara si vijon: "ju njoftojm se i rrim mbrapa qmimit qe kemi ofertuar konform specifikimit teknik te dosje se tenderit dhe informatave sqaruese qe keni dhen me daten 02.05.2017 ora 15:00 " Bazuar ne kerkesen e letres standarde - B41 ne ju kemi pergjegjur asht si ka kerkuar AK pasi kerkesa ka qene " a qendron mbrapa çmimit te ofruar ne ju kemi pergjegjur-konfirmuar se qendrojme mbrapa çmimit te ofruar." Te nderuar ju informojme se kompania e jone me daten 02/05/2017 duke e pare qe kerkesat teknike ne Aneksinl-Specifikat teknike te detyrueshme - Fasiklla të kartonit të fortë me spag (Litar konop) formati B4 kishte nevoje per informata shtese pasi AK asgje nuk kishte kerkuar nga specifikat teknike por ka permend emertimin e artikullit se çka duhet me pas artikulli e mu per kete kemi kerkuar nga AK qe te na dergoi nje moster se si duket fasciklla. Me daten 02/05/2017 ne pranojme nga AK sqarimet ne lidhje me kerkesat qe kan pas OE per informata shtese dhe AK e kthen nje pergjegjeje si vijon:

1) Pyetje:

Kemi nevojë për një informacion shtesë si në vijim:duke marë parasysh se pershkrimi/specifikimet teknike nuk janë shumë të kjarta ju lutem na dergoni një mostër të fasciklës foto në mënyrë që oferta jonë të jetë më e saktë, në përputhje me kërkesat tuaja 2) **Pyetje:**

Ju lutemi te na dergoni nje fototgrafi se si duket fasiklla.

Pergjigje

1. Duke ju referuar njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit për Furnizimi ne fasiklla të kartonit të fort dhe pytjes suaj për informacion shtesë, këto fasiklla përbëhen nga dy kartonë të letrës të fort të cilët duhet të jenë të shpuar në të dy anët në mënyrë që të lidhen me një litar (konop) të fortë në mënyrë që pasi që të sistenohet lënda në të, lidhet dhe e njëjta të ruhet në atë gjendje, ashtu deri sa të përdoret herën tjetër.

2. Referojeni Përgjigjes se pare.

Prandaj bazuar ne informatat shtese ne edhe kemi formuar çmimin ku edhe per ate çmim ne kemi dhënë edhe deklarate se qëndrojmë mbrapa çmimit. Autoriteti kontraktues bene shkelje te procedurave te prokurimit ku pas hapjes se ofertave dhe gjate vleresimit te ofertave na fton kompanine time me telefon(jo me shkrim) qe te shkojme per ta shiquar nje moster te fasciklles se si duhet te jete fasiklla e kete AK e bene jashte procedurave te prokurimit se pas hapjes se ofertave nuk mundet me pas ndonje element qe mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Duke u bazuar ne keto qe u cekem me larte mendojme qe AK me joprofesionalizmin e vete pa te drejte na ka elimuar nga kjo procedure e prokurimit sa qe dyshojme edhe ne Subjektivizem nga ana e AK.

Nuk mundet Autoriteti Kontraktues pasi te bene hapjen e ofertave te ofron mostra se si duhet me qene pasi kete eshte dashte me e bere gjate kohes se njoftimit per kontrate para hapjes se tenderave. Te gjithe OE çmimet i kan vendos ne baze specifikave te kerkuara ne DT , dhe eshte shume joprofesionale qe te tregohen nga ana e AK pas hapjes se tenderave. Ne nuk e dim a e ka bere me qellim apo pa qellim por sido qe te jete kjo procedure nuk eshte zhvilluar sipas procedurave te prokurimit.

Bazuar ne shkeljet flagrante te cilat i ka shkaktuar AK ne lidhje me kete procedure te prokurimit ne paraqesim kete ankese me qellim qe kjo procedure e prokurimit te kryhet sipas ligjit te prokurimit publik. Ne si operator ekonomik na shqeteson fakti se kerkesa e jone per rishqyrtim- eshte shqyrtuar dhe vendosur nga i njejti organ gje qe konsiderojme se paraqet konflikt interesi, shkelje ligjore dhe

dyshime te bazuara ne vendim marrje.

Prandaj duke u bazuar ne te gjitha qe u cekem mendojme qe ne kete procedure te prokurimit ka subjektivizem dhe KERKOJME nge AK ta anulon Vendimin per dhenje te kontrates dhe kete procedure te prokurimit ta anulon per shkak te jo profesionalizimit te AK dhe ta pergadite dosjen e tenderit sipas kritereve dhe rregullave qe i përcakton LPP te Kosovës.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 27.03.2017

Lloji i procedurës së aplikuar:..... e Kuotimit të çmimit.

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e vogël

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 04.05.2017

Data e hapjes së ofertave .....04.05.2017-14:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. *Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr. 04/L042 Neni 65, duhet të dorëzohet obligative*
2. *Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve për tre mujorin e fundit para dorezimit te tenderit.*
3. *Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 30 ditë nga data e dorëzimit të tenderit.*

Dështmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim - kërkohet origjinal
2. Vërtetimi nga ATK - kërkohet kopje.
3. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar

Dokumentet (nën 2 dhe 3) duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla,do të bëjë që tenderi i tyre do të refuzohet, dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë e kështu me radhë.

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1. *Certifikata e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional , komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.*
2. *Certifikata e TVSH-së*
3. *Certifikatën e Numrit Fiskal te lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovë.*

Dështmia e kërkuar dokumentare

1. Certifikata e ARBK-së (kopje).

2. Certifikata e TVSH-së (kopje).
3. Certifikata e Numrit Fiskal (kopje).
Kërkesa(t) për secilin anëtar të grupit në rast se tenderuesi është grup i operatorëve ekonomik:

Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, nga grupi kërkohet që të emërojë njërin nga anëtarët e grupit, si operator për kontakt dhe, së bashku me tenderin e tij, të dorëzojë edhe origjinalin e nënshkruar të marrëveshjes për krijimin e atij grupi.
Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të kenë të drejtën e tyre në pajtim me dispozitat e paragrafit III.2.1). Të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmitë e kërkuara në pajtim me paragrafin III.2.2), te këtij njoftimi.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Office Printy"	Prishtinë	1,980.00€	JO
2.	"Euro Printy"	Prishtinë	3,360.00€	JO
3.	"Grafo Loni"	Prishtinë	3,180.00€	JO
4.	"Media Tech"	Prishtinë	3,720.00€	JO
5.	"Blendi"	Prishtinë	3,600.00€	JO
6.	"Vlora"	Prishtinë	3,540.00€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Azem Flamurtari - Kryetar i komisionit
- Flakron abazi - Anëtar i komisionit
- Adem Godanci - Anëtar i komisionit.

Data e mbarimit të vlerësimit: 16.05.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....17.05.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....17.05.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	**Grafo Loni**	**3,180.00€**	**1**
2.	**Euro Printy**	**3,360.00€**	**2**
3.	**Vlora**	**3,540.00€**	**3**

4.	Blendi	3,600.00€	4
5.	Media Tech	3,720.00€	5

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni ka rekomanduar qe kontrata te nënshkruhet me OE "Grafo Loni", për arsye se i plotëson te gjitha kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit dhe ofron çmimin me te ulet.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se ka ofruar çmim Jo-Normalisht te ulët.

Sqarimi nr.2
AK-ja, gjate vlerësimit te ofertave me date: 16.04.2017, ka kërkuar sqarime OE ankues ne lidhje me çmimin e ofruar dhe njëherit ka kërkuar qe ta sjell një mostër te produktit te cilin e ka kërkuar AK-Këshilli Prokurorial i Kosovës.
Ne po te njëjtën date, ne përgjigje OE ankues ka deklaruar se qëndrojmë prapa çmimit te dhënë ne ofertën financiare.
AK-ja, pas pranimit te përgjigjes se OE ankues, nuk është bindur me çmimin e dhënë nga OE ankues ne ofertën e tij dhe e njofton si tenderues te eliminuar dhe njëherit sipas dispozitave te LPP-se, e njofton edhe Krpp-ne.

Sqarimi nr.3
Eksperti shqyrtues, sqaron se sipas dispozitave e nenit 61.4 te LPP-se, citoj: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. Andaj, eksperti shqyrtues, ne baze te dispozitës se lartpërmendur sqaron se vlerësimi i çmimeve është e drejt e autoritetit kontraktues dhe njëherit sqaroj se AK-Këshilli Prokurorial i Kosovës i ka respektuar dispozitat e nenit 61 te LPP-se.
Eksperti shqyrtues, lidhur me çmimet Jo-Normalisht te ulëta, sqaron se Krpp-ja, me date: 07.07.2016 ka ne ueb faqen e saj ka publikuar Rregulloren për Çmime Jo-Normalisht te ulet, përmes se cilës jepen sqarime se si kualifikohet një ofertë me çmim Jo-Normalisht te ulet.

Sqarimi nr.4
Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet te cilat jepen ne Rregulloren e lartpërmendur sqaron se oferta financiare e OE ankues konsiderohet ofertë me çmim Jo-Normalisht te ulet për faktin se pas përllogaritjes se çmimeve (sipas tabelës) te ofruara nga OE-te pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, rezulton qe pragu është 2,862.00 €. Pra te gjitha ofertat nen këtë çmim, sipas Rregullores për çmime Jo-Normalisht te ulëta konsiderohen oferta me çmime Jo-normalisht te ulet.
Pra ne rastin konkret çmimi i OE ankues prej: 1,980.00€ është çmim nen pragun e lejuar te kësaj

Rregulloreje.
Në fund eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, sqaron se AK - Këshilli Prokurorial i Kosovës, me të drejt e ka eliminuar OE ankues dhe se pretendimet ankimore për shkelje te neneve te përmendura ne ankesë janë te paqëndrueshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Këshilli Prokurorial i Kosovës**, për aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me fasiklla te kartonit te fort me spag (litar konop) formati B4"**, me numër të prokurimit: PSH250/17/003/136, i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës, ndërsa ankesën e OE ankues ta refuzoj si të pa bazuar.